

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit J. S. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP.nr.3773/2012 të datës 04.04.2013, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Elfete Purova dhe të akuzuarit, me datë 23.04.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J. S. nga i ati H. dhe e ëma H. e lindur K., i lindur më datë “data e lindjes ..” në Prizren me banim në fshatin Komuna e Prizrenit – me vendqëndrim të përkohshëm në , ka të kryer shkollën fillore, taksist, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër të kartelës së identifikimit ID..... , me numër të telefonit celular 044 – ... – ... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 07.09.2012 rreth orës 11:10 minuta, në rrugën magjistrale Prizren – në fshatin , nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik aq sa e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë derisa drejtonte automjetin e udhëtarëve të markës “Opel Vectra” me targa të regjistrimit .. – ... – .. , vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 të LSKRR me të arritur afër firmës “.....” pa u siguruar paraprakisht ndërmerr veprime për anashkalim të automjetit të ndalur në rrugë, ku në atë çast në tejkalim të automjetit të pandehurit ishte në tejkalim e sipër automjeti motorik të markës “Mercedes 190” me targa të regjistrimit .. – ... – .. , me ç’rast vjen deri te goditja me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit “Mercedes” në anësin e djathtë përkatësisht në derën e automjetit të akuzuarit e që si pasojë e kësaj të dëmtuarit M. B. i shkakton dëme materiale në automjet dhe lëndime të lehta trupore me ndrydhje të pjesës së qafës, i dëmtuari E. H. merr lëndime të lehta trupore me ndrydhje të pjesës së mbi bërrylit të djathtë të dorës si dhe ndrydhje të pjesës së nën gjurit të djathtë si dhe lëndime pëson edhe bashkudhëtari i akuzuarit A. S. dhe atë ndrydhje të pjesës së krahut të majtë dhe ndrydhje të kurrit të shpinës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor.

Kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

Të dëmtuarit M. (G.) B. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, A. S. nga fshati Komuna e Prizrenit dhe E. (D.) H. nga Prizreni rruga “ ” nr. ... , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit shumen prej 40,88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për tre ekspertiza shumen prej 61.32 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.3773/2012 të datës 04.04.2013, kundër të akuzuarit J. S. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 07.09.2012 në ora 11:10 minuta, në rrugën magjistrale Prizren – , i akuzuari J. S. duke e drejtuar automjetin udhëtarëve të markës “Opel Vectra” me targa të regjistrimit .. – ... – .. , kur arrin në vendin kritik në fshatin afër firmës “ ” e shkel ligjin mbi trafikun publik dhe vepron në kundërshtim me nenin 42 të LSKRR, nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik aq sa e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, gjatë vozitjes pa u siguruar paraprakisht ai ndërmerr veprime për anashkalim të automjetit të ndalur në rrugë, ku në atë çast në tejkalim e sipër të automjetit të pandehurit, automjeti motorik i markës “Mercedes 190” me targa të regjistrimit .. – ... – .. vjen deri te goditja me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit “Mercedes” në anësorin e djathtë përkatësisht në derën e automjetit të akuzuarit, si pasojë e kësaj të dëmtuarit M. B. i shkakton dëme materiale në automjet dhe lëndime të lehta trupore me ndrydhje të pjesës së qafës, i dëmtuari E. H. merr lëndime të lehta trupore me ndrydhje të pjesës së mbi bërrylit të djathtë të dorës si dhe ndrydhje të pjesës së nën gjurit të djathtë si dhe lëndime pëson edhe bashkudhëtari i akuzuarit A. S. me ndrydhje të pjesës së krahut të majtë dhe ndrydhje të kurrizit të shpinës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor.

Gjykata para se të hap seancën fillestare – paraprakisht bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe bëri analizën e provave materiale dhe atë: ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxh. A. S. të datës 09.11.2012, ekspertizën e ekspertit të mjeksisë ligjore Dr. M. S. të datës 10.11.2012, raportet mjeksësore të Spitalit Rajonal në Prizren – Qendrës Emergjente me numër të protokolit , dhe të datës 07.09.2012, skicën e vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacionin, me ç’rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktkauzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e

bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akuzuarit me qëllim që të njëjtat të kundërshtoj dhe të parashtroj prova tjera të cilët do të shkojnë në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari deklaroj se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari në seancën fillestare pranoi fajësisë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, të cilat prova i akuzuari asnjëherë nuk i ka kundërshtuar, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të neni 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tij për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore – është i pa punë dhe është i gjendjes së dobët ekonomike, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri konform neni 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të neni 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.514/2013 të datës 23.04.2015

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.